



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSION I KANALIT TË LINGAJCËS,FAZA IV,BASHKIA PRRENJAS”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45247111-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 69,303,996 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 83,164,795 (tetëdhjetë e tre milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë me TVSH.

Nr.	Emertimi i objektit	Vlera e plotë (lekë me TVSH)	Financimi për vitin 2026	Financimi për vitin 2027	Financimi për vitin 2028
1	Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza IV, Bashkia Prrenjas	83,164,795	17,000,000	25,000,000	41,164,795

Burimi i financimit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga

autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve të viteve: (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në Ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026(kesti i maturuar) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **dyfishi i vlerës limit të kontratës** që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 - 1. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - 2. Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progresive/pjesore

3. *Fatura tatimore te deklaruar ne organet tatimore.*
4. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
5. *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
6. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës*
7. *Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
2. *Situacionin përfundimtar të objektit*
3. *Fatura tatimore te deklaruar ne organet tatimore*
4. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
5. *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
6. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës*

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 45 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara , të cilat vërtetojnë

eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”.*

AK ka kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

Duke qënë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh (0-50%), për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, njesia e prokurimit referuar përcaktimeve të Nenit 39, pika 5, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, ka vendosur të përcaktoj një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përllogaritur të kontratës, një marzh brenda intervalit 0-50% .

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- | | |
|---|----------|
| • N.P-1 (Punime germimi e toke) | Niveli A |
| • N.P-5 (Punime nentokesore, ura vepra,) | Niveli A |
| • N.P-9 (Punime dhe mbrojtje lumore,) | Niveli A |
| • N.P-12 (Punime të inxhinjerise se mjedisit) | Niveli A |

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.S.-8 (Ndertime parafabrikat beton arme,) *Niveli A*
- N.S.-9 (Punime strukturore speciale,) *Niveli A*
- N.S.-18 (Punime topogjeodezike,) *Niveli C*

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Niveli A	Sipas zerave të preventivit
<u>Kategoria N.P-5</u>	Punime nentokesore, ura vepra	Niveli A	Sipas zerave të preventivit

<u>Kategoria N.P-9</u>	<i>Punime dhe mrojtje lumre</i>	<i>Niveli A</i>	<i>Sipas zerave te preventivit</i>
<u>Kategoria N.P-12</u>	<i>Punime te inxhinjerise se mjedisit</i>	<i>Niveli A</i>	<i>Sipas zerave te preventivit</i>
<u>Kategoria N.S.-8</u>	<i>Ndertime parafabrikat beton arme</i>	<i>Niveli A</i>	<i>Sipas zerave te preventivit</i>
<u>Kategoria N.S.-9</u>	<i>Punime strukture speciale</i>	<i>Niveli A</i>	<i>Sipas zerave te preventivit</i>
<u>Kategoria NS-18</u>	<i>Punime topogjeodezike</i>	<i>Niveli C</i>	<i>Sipas zerave te preventivit</i>

2.3.3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm.

- i. Libreze pune (përkatëse)
- ii. C.V (përkatëse)
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi (Profili Struktura)
- 1 (një) Inxhinier Mjedisit
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.3.4.1. Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Libre të pune dhe C.V si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. .

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas DST, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri (Profili Struktura)** është përgjegjës për ndjekjen e punimeve që lidhen me elementët strukturorë të objektit, përfshirë strukturat monolite të betonit, armimin, betonimin, muret, elementët anësorë, kalimet, urat e vogla apo strukturat shoqëruese të parashikuara në projekt dhe preventiv. Ky profil garanton që elementët betonarme të realizohen sipas projektit, specifikimeve teknike dhe kërkesave të sigurisë, duke kontrolluar përgatitjen e kallëpeve, vendosjen e armaturës, cilësinë e betonit, dimensionet dhe detajet konstruktive. Prania e tij është e rëndësishme për të siguruar që strukturat e kanalit të kenë qëndrueshmëri, funksionalitet dhe jetëgjatësi në përdorim.
- **Inxhinieri Mjedis** është përgjegjës për ndjekjen e masave mjedisore gjatë gjithë fazës së zbatimit të punimeve, duke kontrolluar ndikimet që mund të krijohen nga pastrimi i kanalit, largimi i bimësisë, administrimi i aluvioneve dhe mbetjeve urbane, transporti i materialeve, përdorimi i makinerive, pluhurat, zhurmat dhe ndikimet e mundshme në ujërat sipërfaqësore. Duke qenë se objekti ka për qëllim përmirësimin e rrjedhës së ujërave dhe uljen e rrezikut nga bllokimet/përmbytjet, zbatimi i masave mjedisore është i rëndësishëm për të siguruar që ndërhyrja të kryhet pa dëmtonuar mjedisin përreth, tokat bujqësore, rrjedhën natyrore të ujërave dhe kushtet higjieno-sanitare të zonës. Ky profil garanton që punimet të zhvillohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike për mbrojtjen e mjedisit.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për drejtimin dhe kontrollin e punimeve hidroteknike të objektit, të cilat lidhen me rikonstrukcionin e kanalit, përmirësimin e rrjedhës së ujërave, sistemimin e shtratit, kontrollin e pjerrësive, kuotave, seksioneve të kanalit dhe funksionimin e elementëve të largimit të ujërave. Ky profil është i domosdoshëm për të garantuar që punimet të realizohen sipas parametrave të projektuar, duke përfshirë vendosjen e tubacioneve HDPE, kalimet hidraulike, strukturat shoqëruese, elementët e betonit dhe zgjidhjet që sigurojnë largimin e ujërave të shiut dhe shmangien e bllokimeve. Inxhinieri Hidroteknik siguron që objekti të funksionojë sipas qëllimit të tij kryesor, pra kanalizimin dhe largimin e kontrolluar të ujërave, duke ulur rrezikun e përmbytjeve dhe dëmtimeve në zonë.

- **Inxhinieri Gjeodet/ Topograf/ Markshajder** është përgjegjës për piketimin e objektit, kontrollin e aksit të kanalit, kuotave, pjerrësive, seksioneve tërthore dhe gjatësore, si dhe për azhurnimin topografik gjatë zbatimit dhe pas përfundimit të punimeve. Për këtë objekt, roli i tij është thelbësor pasi rikonstrukcioni i kanalit kërkon respektim të saktë të kuotave të projektit, pjerrësive të rrjedhës, gjerësive, thellësive dhe pozicionimit të strukturave shoqëruese. Ky profil ndihmon në shmangien e gabimeve në nivelim, pozicionim dhe formim të kanalit, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin hidraulik të objektit. Gjithashtu, ai është i nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit faktik “as built” pas përfundimit të punimeve.
- **Inxhinieri Gjeolog** është përgjegjës për verifikimin e kushteve gjeologjike të terrenit gjatë zbatimit të punimeve, veçanërisht në zonat ku kryhen gërmime, pastrim aluvionesh, riformim i shtratis të kanalit, mbushje dhe ndërtim i strukturave të betonit. Ky profil është i rëndësishëm për identifikimin e shtresave natyrore, depozitimeve aluvionale, kushteve të lagështisë, pranisë së materialeve të papërshtatshme dhe çdo ndryshimi faktik që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë e tabanit apo të skarpave. Inxhinieri Gjeolog jep vlerësime teknike në rast se gjatë zbatimit konstatohen kushte të ndryshme nga ato të parashikuara, duke ndihmuar në marrjen e masave të përshtatshme për realizimin e sigurt dhe cilësor të objektit.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për ndjekjen dhe kontrollin e proceseve mekanike që lidhen me përdorimin, funksionimin dhe koordinimin e makinerive, pajisjeve dhe elementëve mekanikë të nevojshëm për realizimin e punimeve në objekt. Për këtë projekt, roli i tij lidhet me makineritë e gërmimit, transportit, ngjeshjes, pompimit të ujërave, betonimit, pajisjet ndihmëse të kantierit, si dhe çdo proces tjetër ku kërkohet asistencë mekanike për funksionimin e rregullt të pajisjeve. Ky profil garanton që pajisjet dhe makineritë të përdoren në mënyrë të sigurt, të mirëmbahen gjatë zbatimit dhe të koordinohen me proceset ndërtimore, hidroteknike dhe infrastrukturore, duke shmangur ndërprerjet, defektet dhe vonesat në kantier.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i shoqërisë duhet të jetë te përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknik të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- a) 1(nje) person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si Specialist Per Testimin e Performances se Materialeve/Produkteve te Ndertimit /Inxhinier Materialeve,
(Për specialistin e mesiperm duhen paraqitur çertifikata perkatese , Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b) 1(nje) person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për “Punime në prani/prezence uji”, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

(Për pergjegjesin e Punimeve ne prani uji duhet te paraqitet Certifikata perkatese , Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. .

- c) 1(nje) person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, *”Pergjegjes per sigurine”*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,

Për pergjegjesin *per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune* duhet te paraqitet Certifikata perkatese , Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

- d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet te jete e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje (konform ligjit per cdo kompani me mbi 15 punetore). Mjeku duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Shënim : Disponimi i “1(nje) mjek ndërmarrjeje”, mund të sigurohet nga operatori edhe me anë të kontrates së punës , e cila të jetë e vlefshme gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes, si dhe në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjet punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagesa minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Lloji i Specialistit	Numri i kerkuar
Teknik Ndertimi	2
Teknik Topograf	1
Teknik Mekanik	1
Betonues	5
Murator	5
Hekurkthyes	5
Karpentier	5
Saldator	1
Hidraulik	2
Specialist ndertimi	5

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.				
2.				
etj.				

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose te larte,
- Stafi i punonjësve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi:

Kërkesa e bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa specifike për Stafin e specilisteve është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve, si dhe në përputhje me stafin inxhinierik të kërkuar dhe në bashkëpunim me fuqinë tjetër punëtore do jenë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin si dhe brenda afatit.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik ndërtimi** është i nevojshëm për ndjekjen e përditshme të proceseve të punës në kantier, organizimin e grupeve të punës, kontrollin paraprak të zbatimit të zërave ndërtimore dhe koordinimin ndërmjet stafit inxhinierik dhe punonjësve të specializuar. Ky punonjës ndihmon në sigurimin e vijueshmërisë së punimeve sipas projektit, preventivit dhe grafikut të miratuar.
- **Teknik topograf** është i nevojshëm për asistimin e inxhinierit topograf/gjeodet gjatë proceseve të piketimit, matjeve në terren, kontrollit të kuotave, aksioneve, niveleve dhe azhornimeve gjatë zbatimit të punimeve. Ky profil ndihmon në realizimin praktik të matjeve topografike në kantier, në vendosjen e saktë të elementëve të objektit sipas projektit, si dhe në kontrollin e vazhdueshëm të përputhshmërisë ndërmjet gjendjes faktike në terren dhe kuotave të parashikuara në dokumentacionin teknik. Prania e Teknikut Topograf është e rëndësishme për shmangien e gabimeve në pozicionim, nivelim dhe kuotim, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, funksionalitetin dhe saktësinë e zbatimit të objektit.
- **Teknik Mekanik** është i nevojshëm për ndjekjen, asistimin dhe realizimin e proceseve mekanike të parashikuara në projekt dhe preventiv, përfshirë montimin, përshtatjen, kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, elementëve apo instalimeve mekanike. Ky profil siguron mbështetje teknike gjatë zbatimit të punimeve, garanton funksionimin e rregullt të elementëve mekanikë dhe ndihmon në koordinimin e tyre me disiplinat e tjera teknike, si instalimet elektrike, hidraulike dhe sistemet e tjera ndihmëse të objektit.
- **Betonuesi** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të betonimit në objekt, sipas zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.
- **Murator** është i nevojshëm për realizimin dhe ndjekjen e punimeve që lidhen me ndërtimin, sistemimin dhe përfundimin e mureve, elementëve anësorë dhe strukturave ndihmëse të parashikuara në projekt dhe preventiv. Duke qenë se objekti përfshin rikonstrukcion kanali, veshje/sistemim të skarpave, struktura betoni dhe elementë shoqërues, prania e muratorit është e domosdoshme për zbatimin korrekt të punimeve që kërkojnë formim, rrafshim, lidhje, mbushje, riparim dhe përfundim të sipërfaqeve vertikale apo të pjerrëta të strukturave.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshëm për prerjen, kthimin, përgatitjen, montimin dhe vendosjen e armaturës së hekurit sipas projektit konstruktiv. Ky profil është thelbësor për realizimin e elementëve betonarme, pasi gabimet në vendosjen e armaturës cenojnë qëndrueshmërinë, sigurinë dhe cilësinë strukturore të objektit.
- **Karpentieri** është i nevojshëm për përgatitjen dhe montimin e kallëpeve, elementëve ndihmës të betonimit, skelerive dhe strukturave të përkohshme të punës, sipas kërkesave të projektit dhe kushteve teknike. Cilësia e punës së karpentierit ndikon drejtpërdrejt në formën, dimensionet dhe saktësinë e elementëve betonarme.
- **Saldatori** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të saldimeve speciale në sektore të ndryshme si konstruksione metalike, tuba metalike, etj, si pjesë integrale të realizimit të zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin. OE për Saldatorin e deklaruar duhet të paraqesë certifikatën me EN ISO 9606-1:135 për testimin e saldimit. Për përmbushjen e këtij kriteri do të pranohen vetëm certifikatat të leshuara nga institucione të akredituara ose ekuivalentet e tyre.
- **Hidrauliku** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve që lidhen me sistemimin, vendosjen dhe funksionimin e elementëve hidraulikë dhe të largimit të ujërave, sipas zërave të parashikuara në projekt dhe preventiv. Duke qenë se objekti ka për qëllim rikonstrukcionin e kanalit, përmirësimin e rrjedhës së ujërave, largimin e ujërave të shiut dhe shmangien e bllokimeve apo përmbytjeve, prania e hidraulikut është e domosdoshme për zbatimin korrekt të punimeve që lidhen me tubacionet, lidhjet, shkarkimet, kalimet hidraulike dhe elementët ndihmës të sistemit.

- **Specialisti i ndertimit** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore dhe ndihmëse që nuk kufizohen vetëm në një profil të vetëm, por që kërkojnë eksperiencë praktike në kantier. Ky punonjës mbështet realizimin e zërave të ndryshëm të preventivit, ndihmon në organizimin e punës dhe kontribuon në përfundimin e proceseve ndërtimore sipas afateve dhe cilësisë së kërkuar.

Autoriteti Kontraktor gjykon se pa këta punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ne kohe dhe cilesi, ku për vërtetimin e disponimit të tyre është kërkuar plotësimi dhe paraqitja e të dhënave sipas tabelës të përcaktuar, dhe paraqitja e dokumentacionit, dëshmitë/ certifikatat e kualifikimit të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., në zbatim të Rregullores së Sigurimit teknik për punën në ndërtim, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi 5 (pese) shoferë të mjeteve të rënda/kamioni dhe 5 (pese) manovratorë (2 automakinist, 2 eskavatorist dhe 1 buldozerist), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar,

Per shoferet duhet te paraqiten :

- Kontratë pune të vlefshme,
- Leje drejtimi dhe Certifikatë e Aftësisë Profesionale (CAP)
- Për stafin manovratorë(automakinist, eskavatorist , buldozerist) të paraqiten:
- Kontratë pune të vlefshme,
- Leje drejtimi
- Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimore dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit e kualifikuar si më sipër, pasi kjo kërkesë lidhet ngushtësisht me mjetet e kërkuara në pikën 2.3.8, të dokumentave të tenderit, në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi, ku për drejtimin e mjeteve te vleresuara të domosdoshme për realizimin e punimeve në fjalë, nevojiten drejtuesit respektive, të pajisur me dokumentacionin perkates, ne perputhje me Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore te dala në zbatim të tij.

2.3.7 Ne perputhje me kërkesat dhe specifikat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor ne specifikimet teknike dhe projekt preventiv, per materialet:

- a. Hekur ndertimor;
- b. Hidraulike (tubacione);

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave.
- Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.
- Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standarteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme / ose të pajisur me Çertifikatë konformiteti.

Për plotësimin e pikes 2.3.7, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk janë vetë prodhues apo furnizues të këtyre mallrave duhet ta dokumentojnë duke paraqitur Autorizimet/Kontratat e furnizimit përkatëse si dhe certifikatat e sipër kërkuara për secilin prej mallrave si dhe një vetëdeklarim që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë.”

Argumentimi:

Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, paragrafi 1, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pika 8 e nenit 39 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kjo kerkese eshte vendosur per te garantuar autoritetin kontraktor se operatori ekonomik i ka kapacitet per te ofruar furnizim te vazhdueshëm me materialet e nevojshme per kryerjen e punimeve sipas zërave te preventivit.

Paraqitja e ketyre dokumenteve eshte vlerësuar nga Autoriteti kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Kjo referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testeve të kryera ose ISO, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, njësia e prokurimit bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11 ton dhe maksimumi 18 ton	1 copë	Pronësi ose me qera

Kamion kapaciteti mbajtës minimum 10 ton dhe maksimumi 12 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion kapaciteti mbajtës minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton .	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion kapaciteti mbajtës minimumi 20 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper me kapacitet mbajtes mbi 28ton (mjet teknologjik)	1 copë	Pronësi ose me qera
Buldozer / Rusp me zinxhire me peshe mbi 30ton, dhe fuqi minimumi 200kw	1 copë	Pronësi ose me qera
Buldozer / Rusp me zinxhire me peshe mbi 20ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma (mjet teknologjik)	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me kove para dhe krahe mbrapa (mjet teknologjik)	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Mini Fadrome/ Bobcat (mjet teknologjik)	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik/Cekic Hidraulik ose Pneumatik (per eskavatore)	1 copë	Pronësi ose me qera
Pjese speciale qe i montohet eskavatorit: Pllake Vibruese me Ngjeshese Hidraulike dhe Shpues Spiral Hidraulik dhe Aksesore	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni (te brendshem)	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni (te jashtem)	1 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak me karb. ose elekt., per ngjeshje	1 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per kthim hekur ndertimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per prerje hekur ndertimi	1 copë	Pronësi ose me qera
GPS per rilevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
Total Station per rilevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç ne zinxhir (Tipi vinc-eskavator) me krahe te gjate me kapacitet ngrites mbi 50T (me grejfer)	1 copë	Pronësi ose me qera
Sistem Well Point (ekuivalent)	2 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje furnizimi/bashkepunimi
Nyje Inertesh, pajisur me leje mjedisore nga QKL	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje furnizimi/bashkepunimi

- a)** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); **b)** leje qarkullimi; **c)** certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); **d)** siguracion mjeti (i vlefshëm); **e)** certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

- b) Për mjetet e deklaruar me qera kontrata përkatëse e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit për të trete dhe me qira (e vlefshme).
- c)) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
 - Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues.
 - Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.
- (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekteve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet: “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.

–“Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruara të kalojnë në kontroll teknik...”

–Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për atë kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim...”

–Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se : “Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës...” Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e

informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Mjetet	Sasia	Proceset sipas preventivit
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11 ton dhe maksimumi 18 ton	1 copë	Për transportin e dheut të dale nga germimet dhe transportin materialeve etj nga një vend në tjetrin për zerrat me nr analize:2.37/3b
Kamion kapaciteti mbajtës minimum 10 ton dhe maksimumi 12 ton	1 copë	Për transportin e dheut të dale nga germimet dhe transportin materialeve etj nga një vend në tjetrin për zerrat me nr analize:2.37/3b
Kamion kapaciteti mbajtës minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton .	1 copë	Për transportin e dheut të dale nga germimet dhe transportin materialeve etj nga një vend në tjetrin për zerrat me nr analize:2.37/3b
Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	1 copë	Makine gatishmerie në Kantier, Transporti i veglave dhe materialeve të vogla, për hyrje në rrugë të ngushta.
Kamion kapaciteti mbajtës minimumi 20 ton	1 copë	Për transportin e dheut të dale nga germimet dhe transportin materialeve etj nga një vend në tjetrin për zerrat me nr analize:2.37/3b
Dumper me kapacitet mbajtës mbi 28ton (mjet teknologjik)	1 copë	Nevojitet për zerrat me nr analize:3.88/b, 2.36, 2.37/3b ku për shkak të mungesës së infrastruktures së mirfillte rrugore mund të shfaqen dhe vështirësi në levizjen e kamionave
Buldozer / Rusp me zinxhire me peshe mbi 30ton, dhe fuqi minimumi 200kw	1 copë	Nevojitet për zerrat me nr analize:3.88/b
Buldozer / Rusp me zinxhire me peshe mbi 20ton	1 copë	Nevojitet për zerrat me nr analize:3.88/b
Eskavator me goma (mjet teknologjik)	1 copë	Nevojitet për zerrat me nr analize:3.88/b
Fadrom me kove para dhe krahe mbrapa (mjet teknologjik)	1 copë	Nevojitet për zerrat me nr analize:3.88/b, 2.36
Eskavator me zinxhire	1 copë	Nevojitet për zerrat me nr analize:3.88/b
Autobetoniere	1 copë	Nevojitet për zerrat me nr analize:2.262/4, 2.583, 3.245
Autopompe Betoni	1 copë	Nevojitet për zerrat me nr analize: 3.245
Mini Fadrome/ Bobcat (mjet teknologjik)	1 copë	Nevojitet për zerrat me nr analize:3.396, 3.164/1b,

Autovinç me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	1 copë	Nevojitet per zerat me nr analize:3.644, ne lidhje me ngarkimin edhe shkarkimin e materialeve nga kamionat e renda ne kamionat me te lehte dhe kamioncina dhe per shkarkimin e materialeve prane vendodhjes se punimeve pergjate kanalit
Autobot uji	1 copë	Referuar preventivit dhe specifikimeve teknike nevojitet per transportin e ujit per te kryer perzierjen e betonit dhe proceset e tjera te punes
Matrapik/Cekic Hidraulik ose Pneumatik (per eskavatore)	1 copë	Eshte i nevojshem nëse gjatë gërmimeve ose punimeve dalin materiale të forta që duhet të thyhen.
Pjese speciale qe i montohet eskavatorit: Pllake Vibruese me Ngjeshese Hidraulike dhe Shpues Spiral Hidraulik dhe Aksesore	1 copë	Nevojitet per zerat me nr analize:3.2, 3.3
Vibrator betoni (te brendshem)	1 copë	Nevojitet per zerat me nr analize:2.262/4, 3.245
Vibrator betoni (te jashtem)	1 copë	Nevojitet per zerat me nr analize: 3.245
Tokmak me karb. ose elekt., per ngjeshje	1 copë	Nevojitet per zerat me nr analize:2.36
Kompresor	1 copë	Nevojitet si pajisje ndihmëse që zakonisht shoqëron matrapikun pneumatik
Matrapik	2 copë	Eshte i nevojshem per thyerjen e gureve /shkembijnjeve te vegjel gjate kanalit ku nuk mund te kryhet germimi me mjet tjeter
Makineri per kthim hekur ndertimi	1 copë	Nevojitet per zerat me nr analize:2.166, 2.166/1a
Makineri per prerje hekur ndertimi	1 copë	Nevojitet per zerat me nr analize:2.166, 2.166/1a
GPS per rilevime matje/azhornime topografike	1 copë	Referuar natyres se punimeve nevojiten, per kryerjen e piketimeve dhe kontrollin e kuotave te punimeve gjate zbatimit , me qellim kryerjen e tyre siipas projektit
Total Station per rilevime matje/azhornime topografike	1 copë	Referuar natyres se punimeve nevojiten, per kryerjen e piketimeve dhe kontrollin e kuotave te punimeve gjate zbatimit , me qellim kryerjen e tyre siipas projektit
Autovinç ne zinxhir (Tipi vinc-eskavator) me krahe te gjate me kapacitet ngrites mbi 50T (me grejfer)	1 copë	Eshte I nevojshem per te të realizuar edhe punime të rënda nëse ato parashikohen nga projekti i plotë ose nga faza të tjera të zbatimit

Sistem Well Point (ekuivalent)	2 copë	Eshte I nevojshem në rast se gjatë zbatimit të punimeve hasen ujëra nëntokësore.
Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	1 copë	Nevojitet per zerat me nr analize:2.262/4, 3.245
Nyje Inertesh, pajisur me leje mjedisore nga QKL	1 copë	Nevojitet per zerat me nr analize:3.396,3.164/1b, 3.226, 3.220/1

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

-Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN UNI ISO 9001-2015 e perditesuar (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN UNI ISO 14001-2015 e perditesuar (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-Certifikatën SSH EN UNI ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH EN UNI ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne rastin e bashkimit te perkohshem te shoqerive secili operator duhet te paraqese certifikatat e mesiperme, ne varesi te punimeve qe do te marri persiper konform marreveshjes.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 6 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar

impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret

realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit. ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH EN UNI ISO 45001 – 2023) është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që

do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.9, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.10 a) Operatori Ekonomik duhet të jete i licensuar nga QKB me Kodin III.2.A(1+2) "Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis"-Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin në mjedis.

b) Operatori Ekonomik duhet të jete i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B "Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis"-Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis - Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta(*Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve inerte*), së bashke me Akt Miratimin me kodet 17 01 01; 17 01 02; 17 01 03; 17 01 07; 17 04 07; 17 05 04; 17 05 06; 17 05 08; 17 09 04; në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

c) Operatori Ekonomik duhet të jete i licensuar nga QKB me Kodin III.1.A "Leje mjedisi e Tipit C për aktivitetin: Stacion transferimi përmbetje jo të rrezikshme".

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë QKL-te sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 2, 4, 6 dhe 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës;

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...”

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 2, 4, 6 dhe 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventivi, grafiku etj ... per proceduren respektive jane hartuar nga subjekti i licensuar qe ka hartuar edhe projekt preventivin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij dhe te verifikuara nga specialistet e fushës nga Drejtoria e Planifikimit,Zhvillimit të Territorit / Inxhinier.

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 216 date 13.04.2023. (Bashkengjitur dosjes proceverbali i struktures të posaçme, për përlllogaritjen e fondit limit)

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve /Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialistet e fushës, anëtar te njësisë së prokurimi, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT